



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.0.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETOR 2017**

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Valbon Bytyqi, i cili ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e ekipit, Selvete Foniqi dhe anëtarët Shefkije Beka dhe Adelina Selmani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
5 Qeverisja e mirë.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	19
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	22
Shtojca III: Letër konfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29/09/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Kuvendit gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:



Përgjigja e Menaxhmentit

Menaxhmenti i Kuvendit të Kosovës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (tash e tutje Kuvendi). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Kuvendit se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të

mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kuvendit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Kuvendi kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportin e kontratave të nënshkruara;
- Raportin e detajuar të progresit për investime kapitale; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Të gjitha kërkesat për raportim si në kontekst të PFV-ve ashtu edhe të raportimit të jashtëm ishin përmbushur me një cilësi të mirë dhe ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh kyçe nëpër sistemet financiare, por që përmirësime të mëtejshme janë të nevojshme në disa fusha për të siguruar një menaxhim efektiv.

Realizimi i buxhetit në 91%, paraqet performancë të mirë buxhetore, me përjashtim të investimeve kapitale ku shumica e projekteve kishin mbetur të parealizuara.

Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë: fokusimi dhe rritja e efikasitetit në realizimin e projekteve kapitale, specifikimin e qartë të projekteve dhe vlerësimin objektiv të procedurave të prokurimit, si dhe monitorimin e subvencioneve në përputhje me marrëveshjet.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,828,515	8,208,759	7,452,614	8,517,980	7,951,987
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,828,515	8,208,759	7,452,614	8,517,980	7,951,987

Me rishikim të buxhetit dhe me vendime të Qeverisë, buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,619,756€. Me vendimet e Qeverisë², buxheti final ishte reduktuar në paga dhe mëditjet për 168,732€, si dhe në mallra e shërbime për 259,021€. Arsytet e këtij reduktimi lidhen me faktin që Kuvendi (Deputetët) për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme nuk kishin ushtruar aktivitete për disa muaj dhe kjo kishte ndikuar në uljen e shpenzimeve në këto kategori.

¹ Buxheti final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

² Me vendimin e Qeverisë nr. 10/19 të datës 15.12.2017 dhe vendimin nr.02/22 të datës 27.12.2017

Buxheti final për investime kapitale ishte reduktuar për 1,322,012€. Fillimisht, me rishikim të buxhetit, ishin zvogëluar për 300,000€ për dy projekte³, për të cilat nuk ishin filluar procedura, me pas me vendime të qeverisë ishin zvogëluar edhe për 892,012€. Këto reduktime kanë rrjedhë si rezultat që Kuvendi nuk kishte arritur të lidhë kontratat për këto projekte.

Po ashtu, nga buxheti i investimeve kapitale, shuma prej 130,000€, në përputhje me LMFP⁴ është transferuar në kategorinë mallra e shërbime, për faktin që, buxheti i planifikuar për blerje të automjeteve ishte transferuar në buxhetin për marrje me qira të automjeteve, bazuar në aktivitetin e centralizuar të Agjencisë Qendrore të Prokurimit.

Në vitin 2017, Kuvendi ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 7,452,614€, që paraqet shpenzim më të ulët për 8% krahasuar me vitin 2016. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,828,515	8,208,759	7,452,614	8,517,980	7,951,987
Pagat dhe Mëditjet	6,298,756	6,130,033	5,864,240	5,920,870	6,060,091
Mallrat dhe Shërbimet	1,748,759	1,619,738	1,251,018	1,612,982	1,124,772
Shërbimet komunale	241,000	241,000	197,632	176,436	180,280
Subvencionet dhe Transferet	140,000	140,000	116,533	117,162	120,000
Investimet Kapitale	1,400,000	77,988	23,191	690,530	466,844

Shpjegimet rreth shpenzimeve krahas buxhetit final në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje është shpenzuar 96%. Fondet e pashpenzuara nga kjo kategori ishin në vlerë prej 265,793€. Ky nën shpenzim kishte ndodhur për faktin që Kuvendi nuk kishte arritur që t'i plotësoj 16 pozitë të planifikuara me buxhet;
- Buxheti për mallra dhe shërbime është shpenzuar vetëm 77%. Niveli i ulët i shpenzimeve në këtë kategori ishte për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme, ku deputetet për disa muaj ishin jo aktiv;
- Te shërbimet komunale buxheti është realizuar 83%, megjithëse këtë vit shpenzimet në këtë kategori ishin më të larta në raport me shpenzimet e dy viteve paraqara; dhe
- Buxheti për investime kapitale është shpenzuar vetëm 30%, që paraqet një performancë shumë të ulët buxhetore.

³ Projektet: Qendra e lutjeve të mëngjesit – Cedarsd (100,000€) dhe Krijimi i qendrës së të dhënave në KRK (200,000€).

⁴ Kërkesa nga KRK-ja për transferin nr.238/17 e datës 15.08.2017

Çështja 1 – Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale

- E gjetura** Realizimi i projekteve kapitale këtë vit ishte sfidë e madhe për Kuvendin. Nga 11 projektet e buxhetuara vërehet se në fund të vitit, në nëntë prej tyre nuk ishte shpenzuar fare buxhet, kurse në dy projektet tjera kishte një realizim të ulët pasi që as fondet e tyre nuk ishin shpenzuar plotësisht.
- Niveli i ulët i realizimit të projekteve kapitale tregon se kishte munguar një analizë e mirëfilltë në procesin e planifikimit të projekteve kapitale. Investimet kapitale nga buxheti fillestar deri në final janë reduktuar për rreth 95%. Reduktimet kanë ndodhur kryesisht si pasojë e mos inicimit të projekteve nga njësitë kërkuese, anulimeve të tenderëve për shkak të ankesave dhe transferit të buxhetit nga kapitalet në kategori të mallrave e shërbimeve.
- Rreziku** Planifikimi jo adekuat i projekteve rrezikon arritjen e objektivave të përcaktuara, dhe ndikon që financimi i këtyre projekteve të anulohet apo të mbetet barrë e buxheteve të ardhshme.
- Rekomandimi 1** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i shkaqeve në lidhje me pengesat e hasura në procesin e realizimit të projekteve kapitale, si dhe të nxjerrin mësimet në mënyrë që praktikrat e tilla të mos përsëriten. Performanca e projekteve kapitale duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuara me kohë, në realizimin e projekteve kapitale.

3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel të Kuvendit kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Buxheti final për paga dhe mëditje, në vitin 2017 ishte 6,130,033€. Prej tyre ishin shpenzuar 5,864,240€. Ato kanë të bëjnë me pagat e deputetëve të Kuvendit përfshirë edhe pagesat për komisione. Pagat e stafit administrativ përfshijnë pagat e rregullta, shtesat prej 50% mbi pagën bazë si dhe ngarkesat ditore me nga 5€ në ditë. Po ashtu, me vendim të Kryetarit të Kuvendit në fund vit, stafi administrativ është shpërblyer me nga 600€, duke u thirrur në performancën e mirë. Kuvendi kishte menaxhuar pagat në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Menaxhimi i personelit

Numri i aprovuar i të punësuarve në Kuvend ishte 357, ndërsa numri aktual në fund të vitit sipas PFV-ve ishte 338 punonjës. Ndryshimi rrjedh kryesisht te stafi administrativ ku ende nuk janë plotësuar 16 pozita. Po ashtu, tre deputet nuk ishin në listë në muajin dhjetor të vitit 2017.

Gjatë auditimit kemi trajtuar nëse koeficientët e stafit në sistemin e pagave janë në përputhje me ato në Akt-emërime (kontratat e punës). Nga 10 mostrat e testuara kemi vërejtur se në shtatë prej tyre, koeficientët në Akt-emërime nuk përputheshin me koeficientët në sistemin e pagave. Megjithatë, pas trajtimit të kësaj çështje në memon e auditimit dhe diskutimeve në fazën finale të ekzekutimit Kuvendi ka arritur që akt-emërimet t'i azhurnoj dhe përshtatë me koeficientet përkatës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunal, ishte 1,619,738€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,448,650€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me: shpenzime të udhëtimit, dreka zyrtare, mirëmbajtje ndërtesave, naftë për ngrohje, shërbime kontraktuese, dhe furnizime për zyrë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 140,000€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 116,533€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e entiteteve publike dhe jo publike dhe destinimi i tyre është i rregulluar me rregulloren e brendshme të Kuvendit. Këto subvencione ndahen me vendime nga Kryesia e Kuvendit.

Çështja 2 – Vonesa në raportet kthyesë të subvencioneve

- E gjetura** Subvencionimi i OJQ-ve “Lidhja e Invalidëve dhe Viktimave të Luftës” në shumë 2,000€, dhe “Klubi Alpina” në shumë 5,000€ ishte bërë me qëllimin e përkrahjes së tyre. Neni 3, pika 3, e memorandumit në mes të Kuvendit dhe OJQ-ve përkatëse, parasheh që pas përfundimit të projektit përfituesi të sjellë raportin final mbi shpenzimet e mjeteve. Përkundër përfundimit të projekteve OJQ-të e subvencionuara nuk kishin dorëzuar raportin final të shpenzimit të mjeteve deri në prill të vitit 2018, edhe pse këto projekte vërehet se kishin përfunduar në mars 2017 për subvencionin e parë dhe për të dytin në korrik 2017.
- Rreziku** Vonesat e mëdha në dorëzimin e raporteve finale për shpenzimin e mjeteve nga OJQ-të për mjetet e marra, dhe pamundësia për të monitoruar subvencionin e dhënë, rrezikon që paratë e shpenzuara të mos arrijnë qëllimin dhe efektin e paraparë me këtë subvencion.
- Rekomandimi 2** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se dhënia e subvencioneve mbështetet nga një monitorim efektiv gjatë fazës së përmbushjes përmes raporteve kthyesë me kohë, në mënyrë që të sigurohemi që mjetet janë shpenzuar sipas kërkesës së paraqitur në projekt propozim.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 77,988€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar vetëm 23,191€. Ato kanë të bëjnë me pajisje dhe ndërtesa administrative afariste.

Çështja 3 – Mangësi në definimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave

- E gjetura** Në dosjen e tenderit për projektin “Sistemi i menaxhimit të objektit”, te kriteri për kapacitetet teknike dhe profesionale Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar që njëri nga inxhinierët duhet të ketë certifikatën nga njëri prej kurseve⁵. Operatori Ekonomik (OE) përkundër faktit se e kishte ofruar këtë certifikatë nga KNX, komisioni i vlerësimit e kishte shpallur si të papërgjegjshëm me arsyetimin se nuk ishte certifikata e duhur. Si rrjedhojë ky tender ishte anuluar dhe ri-tenderuar më pas.

Në procesin e ri-tenderimit ishte shkuar me konkurs të projektimit ku përveç kriterëve tjera ishte vendosur përsëri kriteri për certifikatën nga njëri prej kurseve. OE i njëjtë me të njëjtën certifikatë herën e dytë ishte shpallur fitues dhe kishte nënshkruar kontratën në vlerë prej 25,800€.

⁵ Kurset janë: CIBSE; SMC dhe KNX.

-
- Rreziku** Specifikimi jo i qartë i kriterëve dhe analizat e pamjaftueshme në definimin e kërkesave të projektit kanë ndikuar që vlerësimi për të njëjtin kriter të trajtohet ndryshe në po të njëjtin projekt. Si pasojë e kësaj ka ardhur deri te anulimi dhe vonesa në lidhjen e kontratës.
- Rekomandimi 3** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që para shpalljes së tenderit janë definuar saktë kërkesat dhe kriteret e projektit nga njësia kërkuese dhe pastaj nga menaxheri i prokurimit të analizohet se cila nga procedurat e prokurimit është më e përshtatshme për realizimin e tij. Po ashtu, komisionet e vlerësimit duhet të bëjnë vlerësime objektive dhe t'i trajtojnë njësoj dëshmitë e ofruara për kriteret e njëjta.

3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrimit kontabël (SIMFK) vlera neto e pasurisë kapitale ishte 6,042,422€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale ishte 244,418€ dhe stoqet 11,436€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës financiare Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 51,118€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018, të cilat ishin kryesisht fatura të muajit dhjetor.

Detyrimet kontingjente sipas PFV-ve ishin 87,960€, ndërsa pasuritë kontingjente 57,404€.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e Kuvendit për vitin 2016 ka rezultuar në dy rekomandime. Kuvendi kishte përgatitur me kohë një Plan Veprimi, ku kishte paraqitur detajet e masave dhe aktiviteteve se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Nga dy rekomandimet e dhëna njëri ishte zbatuar ndërsa rekomandimi për migrimin e pasurive të blera para vitit 2011 në sistemin e-pasuria ishte në proces të zbatimit.

Kurse raporti ynë i auditimit për vitin 2015 ka rezultuar me katër rekomandime, prej të cilave tri janë zbatuar plotësisht, ndërsa rekomandimi lidhur me regjistrimin e plotë të pasurisë jo kapitale në sistemin e-pasuria ishte në proces të zbatimit.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Kuvendi në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Qeverisja në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, pasqyron një situatë pozitive. Kuvendi ka marrë në konsideratë kërkesat ligjore të parapara me rregullat e MFK-së dhe ka përfunduar me kohë vet-vlerësimin, megjithëse ka nevojë të përfshijë një vlerësim më kritik ndaj arritjes së rezultateve. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

Me gjithë progresin e realizuar në vlerësojmë që disa aspekte të qeverisjes brenda Kuvendit duhet të përmirësohen edhe me tutje. Ne verifikuam se ishte përgatitur regjistri i rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj, megjithëse menaxhmenti duhet të fillojë t'i vlerësojë, monitorojë dhe azhurnojë rregullisht ato. Po ashtu, duhet të marrin masa për të zbatuar rekomandimin për migrimin e pasurive jo kapitale para vitit 2011, rekomandim i përcjellë nga vitet paraprake.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor të brendshëm. NjAB për vitin 2017, kishte planifikuar katër auditime të rregullta dhe një auditim në lidhje me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak. Plani vjetor ishte hartuar duke u bazuar në planin strategjik dhe në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve. Plani ishte realizuar në tërësi dhe NjAB kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e fushave të audituara.

Komiteti i Auditimit kishte mbajtur takime të rregullta tremujore ku ishin vlerësuar dhe trajtuar çështjet e ngritura në raportet e NjAB-së.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Procesi i raportimit të brendshëm në Kuvend funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe sipas ligjit dhe strukturës organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta jo formale me të gjithë drejtuesit e departamenteve, duke diskutuar raportet dhe çështjet tjera për të gjitha aktivitetet e saj. Po ashtu, ekzistojnë edhe raportimet tremujore financiare, si dhe raportimet sipas kërkesave ligjore.

Sipas rregullave të MFK-së, Kuvendi ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut. Regjistri i rreziqeve ishte hartuar në muajin mars kurse në tetor ishte caktuar përgjegjësi për monitorim.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit për menaxhimin e pasurisë e-pasuria.		Menaxhmenti kishte marrë masa dhe kishte krijuar evidenca të sakta për pasuritë në një regjistër të excel-it. Gjithashtu janë në proces për evidentimin e pasurive (të blera para vitit 2011) në regjistrin e-pasuria.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
3.1.3 Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se me rastin e kërkesave buxhetore janë specifikuar qëllimet për dhënien e subvencioneve dhe se ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara.	Po		
3.1.4 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit për menaxhimin e pasurisë e-pasuria.		Menaxhmenti kishte marrë masa dhe kishte krijuar evidenca të sakta për pasuritë në një regjistër të excel-it. Gjithashtu janë në proces për evidentimin e pasurive (të blera para vitit 2011) në regjistrin e-pasuria.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Kuvendit të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm

Për: 

Data: 19. Qershor. 2018, Prishtinë,